

R E L A C I O N

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10129, DATË 11. 5. 2009 “PËR GJENDJEN CIVILE”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar”, propozohet me qëllim zgjidhjen e problematikave të ndeshura gjatë zbatimit të tij, siç janë dy prej çështjeve kryesore lidhur me ndryshimin e politikave të ndjekura nga Këshilli i Ministrave për administrimin e bazave të të dhënave shtetërore si dhe pezullimin për gjashtë muaj të masës administrative që aplikohet ndaj atyre shtetasve që nuk deklarojnë ndryshimin e vendbanimit brenda afateve ligjore.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKË

Hartimi dhe miratimi i këtij projektligji është parashikuar në Programin Analitik të Projektakteve, për Ministrinë e Brendshme, për vitin 2018.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektligji i propozuar synon të përmirësojë disa aspekte të zbatimit të ligjit nr.10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, që lidhen kryesisht me:

- rregullimin e marrëdhënies së punës së nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile në bashki/njësi administrative si dhe në zyrat e arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut, për të qartësuar detyrimet e punëdhënësit, në rastin konkret të kryetarit të bashkisë dhe prefektit të qarkut, të cilët kanë detyrimin për lidhjen e kontratës së punës me nëpunësin e shërbimit të gjendjes civile, që emërohet sipas rregullave të përcaktuara nga DPGJC-ja;
- administrimin e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, në linjë me politikat e administrimit të bazave të të dhënave shtetërore;
- parashikimin në mënyrë të shprehur qartë për ofrimin e shërbimeve nga zyrat e gjendjes civile për shtetasit me vendbanim në juridiksionin territorial të tyre;
- pezullimin e masës së gjobës për gjashtë muaj, nga hyrja në fuqi e këtij projektligji, për mosdeklarimin e ndryshimit të vendbanimit nga shtetasit brenda afateve ligjore.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është hartuar në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe propozon disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar.

Në bazë të pikës 2, të nenit 83, të Kushtetutës, projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar”, propozohet të shqyrtohet dhe miratohet me procedurë të përshpejtuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, si projektligj që përmbush kriteret e përcaktuara sipas nenit 83, të Kushtetutës dhe situatës së krijuar në lidhje me çështjen e mirëmbajtjes së Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010, administrimi i të cilit, me hyrjen në fuqi të këtij projektligji, i kalon autoritetit rregullator koordinues, përgjegjës i bazave të të dhënave shtetërore, AKSHI-t, gjë që do të mundesojë vazhdueshmerinë e mirëmbajtjes së këtij sistemi bazë shtetëror.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrim me *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektligj përbëhet nga 12 nene dhe parashikon ndryshime në nenet 2, 27, 33, 36, 60, 65, 68, 69, 72 dhe shton një nen pas nenit 64, të ligjit nr.10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar”.

Në nenin 1, të projektligjit parashikohet të bëhet një saktësim në pikën 7, të nenit 2, të ligjit, duke propozuar të shtohet fjala “dhe mbiemrat”, për të harmonizuar termin që përkufizohet “emra/mbiemra të papërshtatshëm”, me kuptimin e tij, sipas këtij ligji.

Në nenin 2, të projektligjit, propozohet që në nenin 27, të shtohet një pikë pas pikës 3, me këtë përmbajtje:

“3/1. Aktet e lindjes, të martesës dhe të vdekjes, të mbajtura nga shërbimi i gjendjes civile të vendeve të huaja, mund të paraqiten në zyrën e gjendjes civile në bashki / njësi administrative edhe nga vetë shtetasit.”

Në ligjin në fuqi është parashikuar se:

“3. Aktet e martesës, të mbajtura në postet konsullore, si dhe deklaratimet e lindjes e të vdekjes, të mbajtura në shërbimin e gjendjes civile të vendeve të huaja, për shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, përcillen periodikisht, nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme, në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, e cila ia dërgon për regjistrim zyrës së gjendjes civile përkatëse.”.

Duke qenë se një numër i madh shtetasish shqiptarë jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe përcjellja e të gjitha akteve për fakte juridike të ndodhura jashtë vendit për këta shtetas do të ngadalësonte këtë proces, aktet e mbajtura nga shërbimi i gjendjes civile i vendit të huaj mund të paraqiten edhe nga vetë shtetasit. Pasqyrimi dhe përditësimi i të dhënave do të bëhet drejtpërdrejt nga nëpunësit e zyrave të gjendjes civile në bashki / njësi administrative.

Në nenin 3, të projektligjit propozohet të ndryshohet parashikimi i bërë në fjalinë e parë të pikës 2, të nenit 33, ku përcaktohet se: “Administrimi i Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile”, dhe propozohet që: “Regjistri Kombëtar administrohet nga institucioni përgjegjës i përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave”. Ky ndryshim propozohet në kuadër të ndryshimeve të politikave për përqendrimin e administrimit të bazave të të dhënave shtetërore aktualisht në administrim të institucioneve të administratës publike, nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, duke sjellë efektivitet në kostot për funksionimin dhe mirëmbajtjen e këtyre sistemeve, por dhe me qëllim unifikimin e procedurave operacionale.

Në zbatim të vendimit nr. 673, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, të ndryshuar, në funksion të përmbushjes së veprimtarisë së tij, AKSHI ushtron kompetenca në zhvillimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës hardware dhe software të shërbimeve të qeverisjes elektronike.

Në nenin 4, të projektligjit është propozuar të bëhet një saktësim në nenin 36, të ligjit, në titullin e nenit, për të qenë në përputhje me përmbajtjen dhe duke parashikuar në një paragraf të veçantë procedurën e korrigjimit të rubrikës së emrit, mbiemrit, emrit të babait dhe të nënës, nëpërmjet referimit në dispozitat përkatëse të ligjit në fuqi, të cilat rregullojnë korrigjimin e emrit/mbiemrit, për shkak të një gabimi të provuar material.

Kështu, titulli i nenit bëhet “Plotësimet dhe korrigjimet në Regjistrin Kombëtar”, ndërsa referenca për korrigjimin si gabim të provuar material të rubrikës së emrit, mbiemrit, emrit të babait, emrit të nënës, mbështetet në procedurën e parashikuar në nenin 57/7 e vijues, të ligjit nr.10129, datë 11.5.2009.

Në nenin 5, të projektligjit, është propozuar që në fjalinë e tretë, të pikës 1, të nenit 60, të ligjit, të hiqet fjala “administron”, për të njëjtën arsye siç është argumentuar ndryshimi i bërë në lidhje me administrimin e RKGjC-së, në nenin 3, të këtij projektligji.

Në nenin 6, të projektligjit parashikohet në mënyrë të qartë legjislacioni që rregullon marrëdhënien e punës së nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile në bashki/njësi administrative dhe në zyrat e arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut. Ky parashikim bëhet me qëllim detyrimin e titullarëve të këtyre institucioneve që të respektojnë procedurat e parashikuara në Kodin e Punës, në veçanti në rastin e zgjidhjes së marrëdhënies së punës, e cila mund të shoqërohet me detyrime financiare, që mund të shmangen, nëse zbatohen me rigozitet dispozitat përkatëse ligjore.

Në nenin 7, të projektligjit shfuqizohet shkronja “c”, e nenit 65, të ligjit, në lidhje me administrimin nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, të sistemeve informatike, RKGjC dhe RKA.

Në nenin 8, të projektligjit është propozuar që në nenin 68 të ligjit, të hiqen fjalët “njësisë administrative”, të cilat janë shtuar si rezultat i zëvendësimit të termave, në kuadër të ndryshimeve të reformës territoriale, me ndryshimet që iu bënë ligjit të gjendjes civile, në vitin 2016, por që duhet të hiqen për sa kohë kompetencën e emërimit dhe të lirimit e ka vetëm kryetari i bashkisë dhe jo ai i njësisë administrative.

Në nenin 9, të projektligjit, është parashikuar një shtesë dhe një ndryshim në nenin 69, të ligjit. Në shkronjën “a”, është propozuar të shtohet paragrafi “dhe ofrojnë shërbimin e gjendjes civile për shtetas që kanë vendbanimin brenda juridiksionit territorial të tyre;”, me qëllim që të përcaktohet qartë se shtetasit e marrin shërbimin nga zyra e gjendjes civile ku janë regjistruar, pra ku realizohet lidhja e tyre me territorin. Në përmbajtje të dispozitave aktuale ky koncept nuk rezulton të jetë i shprehur qartë në ligj.

Gjithashtu, është propozuar të ndryshohet shkronja “dh”, me këtë përmbajtje:

“dh. informojnë kryetarin e bashkisë/njësisë administrative si dhe zyrat e arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut për veprimtarinë e tyre, sipas kërkesës së tyre”.

Ky propozim bëhet pasi nuk vlerësohet e nevojshme që zyrat e gjendjes civile të informojnë këshillat vendorë lidhur me veprimtarinë e tyre. Raportet lidhur me veprimtarinë e tyre mund t'i paraqiten kryetarit të bashkisë/njësisë administrative.

Në nenin 10, të projektligjit, është parashikuar që në nenin 72 të ligjit, fjalët “regjistrat e gjendjes civile”, të zëvendësohen me fjalët “Regjistri Kombëtar”. Duke qenë se me ngritjen dhe vënien në funksionim të Regjistrit Kombëtar të

Gjendjes Civile (RKGjC) të vitit 2010, veprimet në regjistrat themeltarë të regjistrimit të popullsisë janë mbyllur dhe çdo veprim për përditësimin e RKGJC kryhet në kohë reale, formulimi i nenit 72, të ligjit duhet të përshtatet me veprimtarinë konkrete që kryejnë zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi administrative, që konsiston vetëm me veprimet e kryera *on-line* në Regjistrin Kombëtar.

Në nenin 11, të projektligjit, është parashikuar një dispozitë kalimtare, me qëllim pezullimin e masës së gjobës për një periudhë prej 6 muajsh, e cila, aktualisht, aplikohet ndaj shtetasve që nuk deklarojnë ndryshimin e vendbanimit, brenda afateve ligjore. Vlera e gjobës, e cila u rrit ndjeshëm me ndryshimet ligjore të ligjit për gjendjen civile, në vitin 2016, nuk solli efektet e pritshme në ndërgjegjësimin e shtetasve për deklarimin e ndryshimit të vendbanimit. Pezullimi për gjashtë muaj i aplikimit të kësaj mase administrative konsiderohet një mundësi, shtysë tjetër për ndërgjegjësimin e atyre shtetasve që nuk kanë deklaruar vendbanimin aktual, përmendim këtu shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të cilët nuk kanë pasur informacionin e duhur për detyrimin ligjor të deklarimit të vendbanimit.

Në nenin 12 është parashikuar hyrja në fuqi e këtij projektligji.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohet Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilave u është deleguar shërbimi i gjendjes civile, si dhe prefektët e qarqeve.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Brendshme.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi i këtij projektligji nuk shoqërohet me efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE